

## **Hapet Thirrja për Aplikime për Bursa për studentët në Universitetin e Bolonjës, Itali**

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitetë për studentët e Universitetit të Tiranës në Universitetin e Bolonjës në Itali për semestrin e dytë të viti akademik 2018-2019.

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- Bachelor (6 muaj);
- Master (6 muaj);

### **Fushat e studimit:**

- Histori dhe Arkeologji;
- Filozofi dhe Etikë;
- Gjuhë e Huaj;
- Ekonomiks;
- Shkenca Politike;
- Psikologji;
- Sociologji;
- Gazetari;
- Kontabilitet;
- Financë-Bankë;
- Marketing;
- Administrim Biznes;
- Punë Sociale;
- Drejtësi;
- Biologji;
- Biokimi;
- Kimi;
- Fizikë;
- Matematikë;
- Statistikë;

Për t'u njojur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti i Bolonjës, ku është e përcaktuar edhe gjuha e programit përkatës, klikoni në adresat:

<http://www.unibo.it/en/teaching/course-unit-catalogue>

<http://www.unibo.it/en/teaching/degree-programmes?corsiper=exchange>

## Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (850 EUR në muaj për studentët);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	840 EUR
<b>8000 KM ose më shumë</b>	<b>1100 EUR</b>

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

Studentët që përsitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

## Procedura e Aplikimit dhe Dokumentat e nevojshme për aplikim:

### Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Bachelor:

-CV (në gjuhën angleze/italiane);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studenti (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);

-Listë notash (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);

-Letër Motivimi në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit;

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Italisht B2 në varësi të programit të studimit);

-\*Learning Agreement;

\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të originës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvilloni në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm sektionin e parë ‘‘Mobility Plan’’. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të nijhet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Bolonjës lëndë të njëjtë me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju nijhen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti ‘‘Learning Agreement’’ tek sezioni ‘‘Commitment’’ firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel departamenti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: [http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning\\_Agreement.pdf](http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf)

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:

-CV (në gjuhën angleze/italiane);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studenti (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);

-Diplomë e nivelit Bachelor;

-Listë notash e nivelit Bachelor (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);

-Listë notash e nivelit Master (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);

-Letër Motivimi në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit;

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B1/Italisht B2 në varësi të programit të studimit);

- \*Learning Agreement;

\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvilloni në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm sektionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të nijhet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Bolonjës lëndë të njëjtë me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju nijhen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti "Learning Agreement" tek sezioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel departamenti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën: <http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning%20Agreement.pdf>

Afati për aplikim: 26 Tetor 2018

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënive me Jashtë dhe Studentët si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al) me subjekt: "Aplikim për bursë në Universitetin e Bolonjës, emrin dhe mbiemrin tuaj".

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!